



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Nr. 23/ prot.  
7

Tiranë, më 20.02.2017

V E N D I M

Nr. 3 datë 20 shkurt 2017

**Mbi zgjedhjen e “Anëtarit” dhe Anëtarit zëvendësues”, përfaqësues i Akademisë së Shkencave në Komisionin Ad-Hoc për verifikimin paraprak të kushteve ligjore dhe kriterëve profesionale dhe morale, si dhe renditjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.**

Në përgjigje të shkresës së Avokatit të Popullit nr.28, datë 16.02.2017 “Për anëtarët e Komisionit të pavarur Ad Hoc” që do të verifikojë dhe vlerësojë paraprakisht kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të ligjit nr. 115/2016, datë 31.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ligjit nr.9655, dt. 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Statutit të saj neni 16, Asambleja e Akademisë së Shkencave u mblodh më datë 20 shkurt 2017 dhe në përfundim me votim të hapur

**V e n d o s i :**

- 1. Akademik Muzafer Korkuti**, për “Anëtar” në Komisionin Ad-hoc për verifikimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Akademik Vasil S. Tole, për “Anëtar zëvendësues” në Komisionin Ad-hoc për verifikimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Ngarkohet Kryesia e Akademisë së Shkencave të dërgojë zyrtarisht rezultatet e votimit në institucionin e Avokatit të Popullit.
4. Vendimi i mëparshëm, nr.1, datë 18 janar 2017 shfuqizohet.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**MUZAFER KORKUTI**

